



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Leje Ndërtimore



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/02-4146

Dt. 05.12.2024

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Liridona Bordoniqi Gjoshi dhe Gëzim (Ibrahim) Gjoshi nga Gjakova.		
Adresa:	Rruga "Marije Shlaku" nr. 31		
Telefoni:	045 503 550	Emaili:	

Emri i Projektit:	Projekti për ndërtimin e objektit të banimit individual, me destinim shtëpi banimi me lokal pune në përdhese, me etazhitet P+1.		
Emri i Projektuesit:	"PARADIGMA" Visar Dula B.I. Rahovec.		
Adresa:	Rruga "Vëllzërit Frashëri pn..		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:			
Adresa: Gjakovë-J-Qytet			
Zona(t) Kadastrale: Gjakovë-J-Qytet	Nr. i parcelave kadastrale: 4759-43	GPS Koordinatat:	

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri <input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim <input type="checkbox"/> Riparim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I <input checked="" type="checkbox"/>	Kategoria II <input type="checkbox"/>
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Përshkrimi: Lejohet ndërtimi i objekteve të banimit individual, me destinim shtëpi banimi, me etazhitet P+1.	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Liridona Bordoniqi Gjoshi dhe Gëzim (Ibrahim) Gjoshi nga Gjakova** i lejohet ndërtimi i objektit të banimit individual, me destinim shtëpi banimi me lokal pune në përdhese, me etazhitet P+1, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) për ndërtim **S=438.35m²**.

Përdhese: (Sip.Bruto): S=212 m²
Kati i Parë: (Sip.Bruto): S=226.35 m²

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese në vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi: **Liridona Bordoniqi Gjoshi dhe Gëzim (Ibrahim) Gjoshi nga Gjakova**, me banim në rrugën “Marije Shlaku” nr. 31, përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02- 4146 të datës 18.02.2024, të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin i objekteve të banimit individual, me destinim shtëpi banimi, me etazhitet P+1, në ngastrën kadastrale me numër: 4759-43, ZK: Gjakovë-J-Qytet, në pronësi të Liridona Bordoniqi Gjoshi dhe Gëzim (Ibrahim) Gjoshi nga Gjakova.

DUMM, përkatësisht zyrtari përgjigjes për lëndën, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Plani i Situacionit 1: 500 i vërtetuar nga DUMM, dt. 12.12.2023.
- Kopjen e planit së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme në pronësi të Liridona Bordoniqi Gjoshi dhe Gëzim (Ibrahim) Gjoshi nga Gjakova lëshuar nga D.GJ.K.P.
- Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë.
- Aktin Noterial – Deklaratë e përbashkët nr. LRP.Nr. 16838/2023, dt. 14.12.2023.
- Aktin Noterial – Deklaratë e përbashkët nr. LRP.Nr. 16835/2023, dt. 19.12.2023.
- Aktin Noterial – Autorizim nr. LRP.Nr. 15499/2023, dt. 13.11.2023
- Pëlqimin Sanitar, me nr.14-530/01-5091, dt. 15.04.2024, lëshuar nga DPI.
- Përgjigjen në kërkesë me nr. 08-320/01-5090, dt. 23.05.2024, lëshuar nga DBPZHR Gjakovë.
- Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr. 4/734 të datës 29.12.2023.
- Pëlqimin nga K.R.U. ”Gjakova” Sh.A. Gjakovë, nr.3717 të datës 28.12.2023.
- Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, nr.429 të datës 21.12.2023.
- Dëshminë mbi kryerje te obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Bankën Ekonomike filiali në Gjakovë me datë 28.10.2024.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga “PARADIGMA” Visar Dula B.I. Rahovec.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 669.50 Euro.

- **Shtojcë:** Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: Plani i Situacionit së bashku me kushte lokacioni, me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, në përpjesë 1:500 të datës 12.12.2023, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për Punë Inspektuese,
- Arkivit.

~~Hartoi aktin~~

~~Zenel Shabani Z.L. Ligjor~~

Zyrtari përgjegjës për lëndën


Mirlinda Mullahaçani I.D.A.



Drejtori


Arben Bakalli